

MANUALI I DELEGATIT

KOMUNIKIMI

Komunikimi i paleve-klubeve, zyrtareve te klubeve zyrtareve te FFK-se, behet permes mjeteve elektronike, permes arkivit te FFK-se, ne raste edhe permes tel.

- **Sekretari Gjeneral i FFK-se**
Eroll Salihu
Tel. 049 979 001
erollsalihu@ffk-kosova.com

- **Zv.Sekretari Gjeneral/zyra Ligjore e FFK-se**
Arianit Ahmeti
Tel.049 979 002
arianitahmeti@ffk-kosova.com

- **Departamenti i Financave**
Agim Gashi
Tel. 049 979 013
financat@ffk-kosova.com.

- **Departamenti i TI**
Dardan Sadiku
Tel. 049 979 019
dardansadiku@ffk-kosova.com

- **Komisioni i Garave**
Avdyl Bellopoja
Tel.038/600-220
Mob.044151064
Email: komisionipergara@ffk-kosova.com

- **Komisioni Disiplinor**
Dukagjin Zefi
Tel.038/600-220
Mob. 044-307 503
komisionidisiplinor@ffk-kosova.com

- **Komisioni I Apelit**
Tel.038/600-220
Mob.
komisioniiapelit@ffk-kosova.com

Administrata e FFK-se-Sektor i Garave

Tel.038/600-220

Email: sektoripergara@ffk-kosova.com

- Agron Shosholli, Superliga/Liga I
Tel.038/600-220
Mobil.049-979-020
Email agronshosholli@ffk-kosova.com

- Baki Berisha, Liga II
Tel. 038/600-220
Mob.049-979-021
Email bakiberisha@ffk-kosova.com

- Valon Sadiku, Superliga-U19/ Liga I-U19/ Superliga-U17/
Tel.038/600-220
Mobil.049-979-090
Email - valonsadiku@ffk-kosova.com

- Valbona Gashi, Superliga Femra "A"/ U16/
Tel.038/600-220
Mobil.049-979-016
E-mail valbonagashi@ffk-kosova.com

2. RAPORTIMI

- Menyra e raportimit te delegatit te ndeshjes, para, gjate dhe pas ndeshjes.
- Detyrat dhe veprimet qe i ndermerr Delegati per sigurimin e kushteve minimale per zhvillimin e nje ndeshje zyrtare ne territorin e R.Kosoves.
 - a. Raporti i Delegatit eshte shume i rendesishem, duhet te jete i kompletuar i plote dhe me kohe.
 - b. Lista e ekipeve- Listen e ekipeve e perbejne personat zyrtarë Futbollistët , trajnerët, zyrtarët e ekipit që përfaqsojne dy ekipet.
 - c. Lista e lojtarëve- Secili ekip është i detyruar ta përpilojë listën e futbollistëve qe do të marrin pjesë në lojë së bashku me lojtarët rezervë, si dhe me stafin profesional , më së voni 75 min para fillimit të ndeshjes. Lista përpilohet nga menaxheri i klubit përmes sistemit online të garave (ose e printuar dhe nenshkruar/vulosur nga klubi, nese nuk mundet te perpilohet permes sistemit online).
 - d. Fair Play – Forma e Fair Play perpilohet nga Delegati pas konsultimit me referet dhe kontrollorin e refereve, duhet të plotësohet më së largu 48h pas përfundimit të ndeshjes.
 - e. Kërkesat minimale mjekësore – Delegati duhet të kontrolloj kërkesat minimale mjekësore së paku 90 min para ndeshjes.
 - f. Rimbursimi – Delegati duhet ta plotësoj formularin e rimbursimit më së largu 24h nga dita e ndeshjes, dhe ta dërgoj tek departamenti I financave tek email: financat@ffk-kosova.com
 - g. Raporti plotësues – Raporti plotësues i ndeshjes (në rast të incidenteve etj) duhet të plotësohet më së largu 24h pas përfundimit të ndeshjes duke ja bashkangjitur provat materiale si : Foto dhe dëshmi të tjera rreth këtyre ngjarjeve. Ky raport duhet të ngarkohet në sistemin digjital të garave, dhe duhet të dërgohet përmes emailit : komisionipergara@ffk-kosova.com
 - h. Raporti i Delegatit – Duhet të plotësoj raportin e ndeshjes më së largu në ora 08:00 te mengjesit pas përfundimit te ndeshjes. Raportin lidhur me kartonat, golat, etj. e përpilon referi të cilin ja dorzëzon delegatit cili duhet të plotësohet menjëherë pas ndeshjes dhe të ngarkohet në sistemin online te garave
 - i. Flash Raporti -1MD - Duhet të plotësohet një ditë para ndeshjes, e cila duhet të dërgohet më së largu deri në ora 12 tek Komisioni I Garave në emailin: komisionipergara@ffk-kosova.com
 - j. Flash Raporti MD – Duhet të plotësohet ditën e ndeshjes më së largu deri ora 12, e cila duhet të dërgohet më së largu deri në ora 12 tek Komisioni I Garave në emailin: komisionipergara@ffk-kosova.com
 - k. Organizimi i ndeshjes – Takimi organizativ mbahet në ditën e ndeshjes më së largu në ora 10:30 të cilin takim e organizon Delegati , ku marrin pjesë : Zyrtarët e klubeve, Personat për Siguri të klubeve, Policia, Zjarrfikësit si dhe Ekipi Mjekësor.

3. BAZA LIGJORE

Rregullorja e garave 2019/2020, Rregullorja Disiplinore e FFK-së

Është me rëndësi të ketë kujdes të veçantë në :


- Numri i lojtareve zëvendësues
- Numri i lojtarëve zëvendësues nese loja shkon në vazhdime
- Numri maksimal i lojtarëve rezervë të cilët mund të shënohen ne listën e lojtarëve
- Numri dhe lokacioni I karrikeve shtesë në bankinë
- Komunikimi dhe përdorimi i mjeteve elektronike në bankinë
 - Përdorimi I pajisjeve elektronike në bankinë është I lejuar vetëm nëse gjatë komunikimit nuk paraqet ndonjë rrezik për lojtarët, trajnerët dhe zyrtarët të cilët qëndrojnë në bankinë.
 - Si psh: telefonat mobil, laptopët si dhe pajisjet e tjera që mund të mbahen në dorë.

Numri i zëvendësimeve

Per ndeshjet me 3 zevendesime ne kohe normale, zevendesimi i katert mund te ndodh nese ndeshja shkon ne kohe shtese. Shembull numri I lojtarëve, zyrtarëve, zyrtarëve shtesë, zëvendësimet.

		Numri i:					Përdorimi pajisjeve elektronike në zonën teknike
		Lojtarëve(ne listën e ndeshjes)	Lojtarët rezervë	Zyrtarët e Ekipit(në bankinë)	Karrika shtesë	Nr i zevendesimeve	
Senioret	IPKO Superliga	18	7	7	5	3	PO
	Liga e Parë	18	7	7	/	3	PO
	Liga e Dytë	18	7	7	/	3	PO
	Liga e Tretë	18	7	7	/	3	PO
	Kupë	18	7	7	5	4	PO
Gjeneratat e reja							
	Superliga U19	18	7	7	/	5	PO
	Liga e Parë U19	18	7	7	/	5	PO
	Liga U17	18	7	7	/	5	PO
Femrat	Superliga	18	7	7	/	3	PO
	Liga U16	18	7	7	/	3	PO
	Kupe	18	7	7	/	4	PO
Regjionet	U19	18	7	7	/	5	PO
	U17	18	7	7	/	5	PO
	U15	18	7	7	/	5	PO
	U13	18	7	7	/	7	PO
	U11	18	7	7	/	7	PO
	U9	18	7	7	/	7	PO

Shembulli i mënyrës së zëvendimeve:



* a 4th substitution in extra time has been allowed at final tournaments, but was not part of the regulations.

4. SHITJA E PIJEVE ALKOHOLIKE

Shitja e pijeve alokoholike dhe jo-alkoholike si dhe ushqimit në stadium e dedikuar për të pranishmit, rregullohet sipas Ligjit mbi Parandalimin e Dhunës dhe Dukurive në Ngjarje Sportive dhe është ne përgjegjesi te ekipit organizator te ndeshjes.

Organizatori në mbledhjen e organizuar para ndeshjes, duhet të raportoj te delegati për mënyrën e organizimit të shpërndarjes-ofrimit për pije alkooloike dhe joalkoolike, ushqimi, ambalazhin e lejuar për pije dhe ushqime, që do të ofrojnë para, gjatë zhvillimit të ndeshjes për të pranishmit në stadium.

5. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

5.1 Delegati i ndeshjes

- Delegati i ndeshjes është personi zyrtar i caktuar nga administrata e FFK-se.
- Është personi i cili kujdeset që loja të zhvillohet konform rregullave dhe normave juridike sipas rregullores së garave të FFK-së në përputhje me standardet e sigurisë brenda dhe jashtë stadiumit, para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes.
- Është në kontakt të vazhdueshëm me administratën e FFK-së.
- Është autoriteti më i lartë në aspektin e organizimit të ndeshjes.
- Raporton për të gjitha incidentet para, gjatë dhe pas ndeshjes.
- Duhet që gjithmonë të jete objektiv dhe neutral gjatë raportimit.
- Të jetë profesional gjatë gjithë kohës.
- Të dialogojë dhe komunikoj me palët e treta.
- Të tregoj Leadership.
- Të merr vendime kur nevojiten.

5.2 Shoqëruesi i Deleqatit

- Është personi i caktuar nga klubi vendas
- Është në komunikim me delegatin një ditë para fillimit të ndeshjes
- Është shoqërues i delegatit gjatë gjithë ditës së ndeshjes

5.3 Kontrollori i Referëve

- Është personi i cili delegohet nga Komisioni për Referim.
- Është personi që është në mbështetje të ekipit të referëve.
- Është personi i cili vëzhgon performancën e referëve.
- Merr pjesë në takimin organizativ në ditën e ndeshjes(ora 10:30) me delegatin e ndeshjes si dhe pjesëmarrësit e tjerë.
- Është në shoqërim permanent me Deleqatin, para, gjatë e deri në përfundimin e raportit të ndeshjes.

5.4 Referët

- Caktohen nga komisioni për Referim.
- Është autoriteti më i lartë për aplikimin e rregullave të lojës.
- Mund të konsultohen me delegatin e ndeshjes, në ngjarjet që lidhen me sigurinë gjatë zhvillimit të ndeshjes.
- Njoftojnë kontrollorin e referëve dhe delegatin e ndeshjes për ndonjë parregullsi apo ndonjë incident si dhe plotësojnë Raportin e ndeshjes sa i përket referimit.

5.5 Shoqëruesi i Referëve

- Është personi i caktuar nga klubi vendas.
- Është në komunikim me referët ditën e ndeshjes.
- Është shoqërues i referëve gjatë gjithë ditës së ndeshjes.

5.6 Personi për siguri

- Caktohet nga ekipi vendas.
- Kujdeset dhe raporton mbi masat e sigurisë të ndërmara tek Delegati i ndeshjes.
- Merr pjesë në Takimin Organizativ para ndeshjes.
- Është në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet publike të sigurisë.
- Raporton për incidentet eventuale që mund të ndodhin para, gjatë dhe pas ndeshjes tek Delegati i ndeshjes.
- Është personi përgjegjës për dhënien e Akreditimeve si dhe kufizimin e lëvizjes me to.

5.7 Zyrtari për media

- Është personi i caktuar nga klubi vendas.
- Raporton te Delegati i ndeshjes për masat e ndërmara lidhur me gjitha aktivitetet e mediave dhe marketingut para, gjatë si dhe pas ndeshjes.
- Është ura lidhëse në mes FFK-së, ekipeve dhe mediave të akredituara.

5.8 Zyrtari për Doping Kontrollë

- Është personi i caktuar nga administrata e FFK-së në baza ad hoc.
- Është me profesion Mjek i fushës – specialist.
- Mbërrin në stadium , jo më heret se 60 min para fillimit të ndeshjes.
- Ai mund të arrijë, në qdo kohë deri në përfundimin e ndeshjes.

5.9 Klubi vendas

- Duhet ti nënshtrohet rregullave të sigurisë në të gjitha ndeshjet dhe duhet ti ndërmerr të gjitha masat e sigurisë për secilin person prezent në stadium.
- Duhet të sigurojë të gjitha kërkesat e nevojshme sipas rregullores mbi kategorinë e stadiumit.
- Duhet ti nënshtrohet Ligjit mbi parandalimin e dhunës dhe dukurie negative në ngjarje sportive, dhe ligjeve tjera të aplikueshme në Kosovë.

5.10 Menagjeri i Ndeshjes

- Është personi i caktuar nga ekipi vendas, i cili përfaqëson ekipin në ndeshje zyrtare.
- Është kontakti kyq me delegatin.
- Është personi i cili përpilon-apo kujdeset që lista e futbollistëve dhe zyrtarëve të lojës, të përpilohet me kohë dhe të shpërndahe te personat zyrtar si: Delegati, Referët, Doping Kontrolla, Ekipi Kunshtar, Media, si dhe me kohë të ngarkohet në sistem Digjital të garave.
- Është personi i cili në fund të ndeshjes raporton para delegatit për përfundimin e ndeshjes, në rast të ndonjë incidenti apo dukurie që ka ndodhur para, gjatë dhe pas ndeshjes, para se Delegati të plotësoj Raportin e ndeshjes.

6. Koha

- Koha e arritjes së ekipeve duhet të jetë më së largu 75 min para fillimit të ndeshjeve.
- Duhet të kontrollohen pajisjet minimale mjekësore për zhvillimin e ndeshjes më së largu 90 min para fillimit të ndeshjeve.
- Më së largu 75 min para fillimit të ndeshjes, duhet të dorëzohet lista e lojtarëve(të ngarkohen në Sistemin Digjital të Garave), dhe fizikisht të dorëzohen te : Delegati, Referët si dhe Mediat.
- Nga 60 min para ndeshjes e deri në përfundimin e ndeshjes , zyrtari për Doping Kontrollë mund të jetë present dhe duhet të pajiset me listën e lojtarëve të dy ekipeve.
- 30 min para fillimit të ndeshjes duhet të kontrollohen hyrjet e tifozëve dhe procedurat e sigurisë.
- 5 min para fillimit të ndeshjes, delegati duhet të ulet në tribunën kryesore.
- Fillimi i lojës – Kick Off : Të përcillet – shikohet pjesa e parë.
Pjesa e dytë: Të shikohet pjesa e dytë
- Të vëzhgohen ekipet duke lënë fushën (në rast incidenti).
- Pas lojës, të bisedohet me ekipet dhe referët në rast të ndonjë qështje ose incidenti.
- Te diskutohet me referët dhe të mbushet formulary i Fair-Play me ta.
- Të kontrollohet që zyrtari i Doping kontrolles nese I ka të gjitha pajisjet e nevojshme.
- Të takohet me Menagjerin e ndeshjes, zyrtarin për siguri, zyrtarin policor present nëse kanë për të shtuar diqka.
- Të mbushë raportin bazë menjëherë pas ndeshjes(golat, kartonat dhe informacionet bazë)
- Të kompletoje raportin e delegatit online më së largu ora 8 të mëngjesit (të nesërmen).
- Nëse është e nevojshme, apo të ketë pasur ndonjë incident kërkoni ndonjë provë si : foto, raport policor, rapor të ekipeve etj të cilat mund të ju nevojiten për raportin e juaj plotësues.
- Të nesërmen, pas lojës më së largu 24h pas ndeshjes duhe të kompletohet raporti plotësues me prova dhe fakte.

Rimbursimi i Delegatit

- Plotësoni formën për rimbursim e mëditjes dhe të dërgohet në email: financat@ffk-kosova.com
- Të kompletohet raporti Fair Play dhe të dërgohet në emailin : komisionipergara@ffk-kosova.com

7. Përgaditja e juaj

1. Komisioni i garave do të ju dërgoj një email me të cilin do të njoftoheni se ju do të jeni zyrtari- delegati në ndeshjen e rradhës.
2. Njoftimin ju do ta pranoni nga 7 e më së largu 2 ditë para fillimit të ndeshjes.
3. Ju do të konfirmoni prezencën e juaj në ndeshjen e rradhës më së largu dy ditë para fillimit të ndeshjes në të njejtin email prej të cilit e keni pranuar.
4. Ju do ta pranoni një email nga Komisioni i garave me formularët e nevojshëm për organizimin e ndeshjes të cilën do të shpërndani përmes Menagjerit të ekipit vendas.
5. Udhëtimi do të bëhet nga ana e delegatit, me mjete të cilat ai vendos dhe i zgjedhe vetë.
6. Pas përfundimit të ndeshjes, delegati do ta plotëson formularin e rimbursimit pas përfundimit të ndeshjes-24h .

7.1 Dita para ndeshjes (Match Day -1)

1. Pas pranimit të e-mailit me formularët e nevojshëm për organizimin e ndeshjes, delegati do të kontaktoj Menaxherin e ndeshjes të ekipit vendas .
2. Përmes emailit do të dërgoj për të plotësuar dhe konfirmuar dokumentet:
 - 2.1. Agjenda (Konfirmimi i gjendjes së fushës).
 - 2.2. Kërkesat minimale mjekësore.
 - 2.3. Flash RaportiTë gjitha këto kërkesa duhet të plotësohen dhe të dërgohen delegatit para orës 12 (mundet të dërgohen direkt tek komisioni i garave duke shtuar ne korrespondencë delegatin e ndeshjes).
3. Cdo komunikim duhet të përfshihen në korrespondencë klubi vendas, klubi musafir, delegati dhe FFK
4. Këto dokumente të cilat i pranon delegati i ndeshjes nga Menagjeri i lojës së ekipit vendas, i dërgon tek komisioni i garave më largu në ora 12 një ditë para ndeshjes.

Shembull Flash Raporti një ditë para ndeshjes:

Flash Raporti një ditë para ndeshjes (12:00)

Data e ndeshjes:		Koha e fillimit të ndeshjes:	
Ekipi vendas:		Ekipi mysafir:	
Delegari i FFK-së:			

Gjendja e fushës, a paraqet ndonjë rrezik për ndeshje?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO	
A është gjendja e fushës ne gjendjen më të mirë të mundshme?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO	
A paraqet moti ndonjë rrezik për ndeshje(shi, mjegull, borë)?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO	
Cila është parashikimi i motit për ndeshje?		
A ka ndonjë problem lidhur me infrastrukturën e stadiumit?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO	
A ka paraqitur ndonjëri prej klubeve ndonjë shqetësim rreth organizimit?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO	
A ka ndonjë shqetësim rreth sigurisë?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO	
Pritshmëritë rreth numrit të spektatorëve?		
Pjesëmarrje e ekipit mysafir?		
A janë plotësuar kërkesat minimale mjekësore?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO	
A ka ndonjë shqetësim rreth organizimit të ndeshjes?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO	
A ka ndonjë s/hqetësim për ndonjë lëshim tjetër	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> JO	

Ky raport duhet të plotësohet dhe të ngarkohet në sistemin digjital të garave, si dhe të dërgohet në email tek Komisioni i Garave .

7.2 Dita e ndeshjes (Match Day)

Në ditën e ndeshjes, delegati i ndeshjes do të fillojë inspektimin e fushës dhe hapësirave të stadiumit si : Zhveshtoret e ekipeve, dhomën e referëve , zyren e delegatit së bashku me kontrollorin e referëve(osë përfaqësuesin e referëve) e cila duhet të fillojë 3 orë para fillimit të ndeshjes.

- Duhet të kontrollojë :
 - Gjendjen e fushës (me parametrat adekuatë)
 - Golat dhe rrjetat
 - Vendodhja e personave me barelë (për ndihmë të shpejtë)
 - Pozicioni i kamerave
 - Pozicionimi I reklamave (sipas rregulloreve dhe standardeve)
 - Bankina e ekipeve, nr i ulëseve të lejuara si dhe ulëset shtesë
 - Bankina e referit të katërt
 - Prezenca e semaforit
 - Dhomat e ekipeve
 - Dhoma e delegatit (e pajisur me pajisjet e domosdoshme si kompjuter si dhe te sigurohet qe interneti është duke punuar)
 - Dhoma mjekësore për lojtarë, referë dhe zyrtarë të FFK-së.
 - Lokacioni i doktorit për intervenim në fushë.
 - Lokacioni i ambulancës

7.3 Menagjeri i Ndeshjes

- Në takimin organizativ, duhet të marrin pjesë: delegati I ndeshjes, menagjeri I ekipit vendas, përfaqësuesit e klubeve si dhe zyrtarët për siguri.
- Takimin e udhëheq delegati I cili prezenton gjendjen e fushës, gjendjen e stadiumit në përgjithësi si dhe masat që kanë ndërmarrë organizatori për zhvillimin e ndeshjes.
- Përfaqësuesi I referëve e jep vlerësimin e tij.
- Përfaqësuesi i organave publike (policia, zjarrëfikësit) e jep vlerësimin e tij.
- Përfaqësuesit e ekipeve prezantojnë pajisjet sportive me të cilat do të zhvillohet ndeshja para përfaqësuesit të referëve dhe delegatit , ku vendimin final e merr referi në bashkëpunim me delegatin

7.4 Flash Raporti në ditën e ndeshjes

Flash raportin delegati duhet ta plotësoj dhe dërgojë më së largu në ora dy orë e gjysmë para fillimit të ndeshjes tek komisioni i garave.

Nëse shfaqet ndonjë qështje emergjente, ekipi vendas e ka për detyrim të merr të gjitha masat e duhura që të mos vihet në pyetje zhvillimi i ndeshjes.

Flash Raporti në ditën e ndeshjes (12:00)

Sigurohuni që jeni duke përdorë Flash Raportin të ditës së djeshme .

Nëse vëreni ndonjë dukuri që do të vinte ndeshjen në rrezik , ju lutemi thirrni nr e FFK-se për urgjenca +383 38 600220.

A ka pasur ndonjë problem gjatë inspektimit të fushës(gjendja e fushës, vijat e fushës, golat, vendosja e kamerave etj)?	<input type="radio"/> PO <input checked="" type="radio"/> JO	
A ka pasur ndonjë shqetësim rreth motit?	<input type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	
A ka ndonjë shqetësim rreth ngjyrave të fanelave të ekipeve?	<input type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	
A ka ndonjë shqetësim rreth sigurisë parashtruar në Takimin organizativ?	<input type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	
A ka ndonje aktivitet të planifikuar të tifozëve(mozaik, banera, etj)?	<input type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	
A ka ndonjë problem tjetër?	<input type="radio"/> PO <input type="radio"/> JO	

Ky raport duhet të plotësohet dhe të ngarkohet në sistemin digjital të garave, si dhe të dërgohet në email tek Komisioni i Garave .

8. Detyrat gjatë ndeshjes

8.1 Delegati

Gjatë ndeshjes delegati, me kujdes vëzhgon-shikon ndeshjen dhe merr shënime relevante si dhe foto në rast të hyrjes në fushë, në rast të pankartave raciste, fishekzjarreve, sjelljeve jo-sportive të lojtarëve dhe zyrtarëve pas shpinës së referit, situatave konfuze si dhe sjelljeve të tjera në kundërshtim me normat juridike të rregulloreve të cilat delegati duhet ti kompletojë dhe ti raportojë pas lojës.

Delegati mund ta shfrytëzojë pushimin e pjesës së parë për të diskutuar për incidente serioze me referët, organizatorin si dhe dy ekipet.

8.2 Shënimet gjatë lojës

Gjatë lojës delegati duhet të vëzhgojë sjelljet e publikut dhe zyrtarëve. Duhet të merr shënime si psh:

- Kohën (nga ardhja e ekipeve, ardhja e zyrtarëve, dorëzimin e listës së lojtarëve dhe zyrtarëve e deri te fillimi I ndeshjes)
- Incidentet e shikuesve (vendat dhe mysafir) si dhe nr i tyre.
- Natyra e incidentit dhe impakti në lojë
- Përdorimi i mjeteve piroteknike (Në cilën pjesë janë hedhur, a është goditur dikush, etj).
- Reagimi i Stafit të sigurisë rreth incidenteve.

8.3 Thirrja e takimit të sigurisë

- Takimin e sigurisë e thërret delegati I ndeshjes. Në të marrin pjesë personat relevant në aspektin e sigurisë, si: Përfaqësuesi I policisë, përfaqësuesit e ekipit vendas dhe mysafir përfaqësuesit tjerë që mirren me sigurinë publike.
Nëse referi e ndërpre lojën, delegati duhet të shkoj menjëher në fushë dhe të konsultohet lidhur me vazhdimin apo ndërprerjen e ndeshjes.
- Nëse ndeshja është ndërprerë, menjëherë ju duhet ta thirrni nr.tel. kujdestar të FFK-se 038600220, vëzhgoni reagimin e stafit të sigurisë, merrni foto të incidentit, mundohuni të gjeni prova të tjera dhe të merrni raporte nga persona të ndryshëm si psh. nga autoritetet e policies, etj.
- Pas përfundimit të ndeshjes, diskutoni lidhur me incidentet me : ekipet, referët si dhe stafin e sigurisë së stadiumit në mënyrë që raporti I juaj të jetë sa më konkret.

9. SHËNIMET PAS NDESHJES

9.1 Permbledhja e raportit

- Në princip mos e lëshoni vendodhjen e juaj deri sa referët dhe lojtarët e dy ekipeve të lëshojnë fushën të sigurtë,
- vëzhgoni-shikoni largimin e shikuesve nga stadiumi, në rast të ndonjë incidenti të jeni dëshmitar
- shkoni te dhoma e referëve:
- Diskutoni për ndonjë incident të ndodhur gjatë ndeshjes
- Kontrolloni me referët lojtarët dhe rezervat të cilët janë përjashtuar ose shënuar nga referët
- Shikoni dhe siguroni që raporti i referëve të dërgohet në FFK në mënyrën elektronike
- Te dakordoheni me referët lidhur me plotësimin e raportit Fair Play
- Kontrolloni stadiumin në rast të ndonjë dëmtimi eventual të bër gjatë zhvillimit të ndeshjes, brenda dhe jashtë stadiumit,
- Përpiloni raportin e delegatit dhe dergojeni në FFK,
- Mbajeni një kopje të Raportit të delegatit dhe Fair Play raportit.

9.2 Aktivitetet pas ndeshjes

- Menjëherë pas ndeshjes vëzhgoni situatën në fushë dhe shikoni ndonjë konflikt ndërmjet lojtarëve, zyrtarëve ose shikuesve,
- shkoni poshtë te tuneli dhomat e zhveshjes vëzhgoni në rast të ndonjë incidenti të mundshëm,
- bisedoni me zyrtarët e tjerë që çdo gjë ka qenë në rregull,
- bisedoni me Antidopingun në rast të ndonjë incidenti apo raporti shtesë,
- Bisedoni me oficerin e sigurisë 30 deri 45 minuta pas përfundimit të ndeshjes, për shkëmbimin e informatave mes vete,
- Bisedoni me Kontrollorin e referëve para se të përfundoni raportin e delegatit,
- Gjithmonë bisedoni me përfaqësuesit e klubeve dhe zyrtarët e tjerë para përfundimit të raportit të delegatit,
- Diskutoni me referët dhe kontrollorin e referëve lidhur me raportin Fair Play,
- Në rast të ndonjë incidenti bisedoni me autoritetet e sigurisë për detajet,
- Kontrolloni dhomat e zhveshjes se ekipeve lidhur me gjendjen,
- Kompletioni raportin e delegatit.

10. Raporti i Deleгатit

Raporti i delegatit duhet të përmbajë:

- **Incidentet lidhur me sigurinë**
 - A ka pasur ndonjë incident në stadium apo qytet?
 - A ka pasur ndonjë tifoz të arrestuar?
 - A ka pasur ndonjë biletë të falsifikuar?

- **Brohoritjet ne masë**
 - Pyroteknika, hedhja e objekteve, rrahja, hyrja në fushë, shkallët e bllokuara, fyerjet raciste.

- **Nga cili ekip – grup tifoz ka ndodhur**
- **Natyra e dhunës, ne detajet e mundshme**
- **Pyroteknika**
 - Sa mjete piroteknike,
 - Në cilën kohë kanë ndodhur,
 - Nga cilët tifoz dhe në cilën pjesë të stadiumit,
 - Cfarë tipi të pyroteknikës, sa numerikisht dhe ku janë hedhur,
 - A është goditur ndonjë person, nëse po në cilën pjesë të trupit,
 - Cka i nxiti për këto veprime.

- **Hyrja në hapësirat e stadiumit (në fushë, haps.e atletikës, etj.)**
 - A ishte rast i izoluar
 - Numri i personave të involvuar, cilët shikues-tifoz nga cila anë e stadiumit,
 - Cka i shtyri në këtë veprim,
 - Sektori i stadiumit nga erdhën veprimet
 - Veprimet e personelit të sigurisë të stadiumit lidhur me kundër veprimet,

- **Dhuna**
- **Rrahja në mes të tifozëve**
 - Numri i personave të përfshirë në këtë rrahje dhe reflektimi
 - Nga cila anë dhe nga cilët tifoz
 - Përshkruani dhe fotografoni dëmet e shkaktuara
 - Hudhja e objekteve (llaserët, gurët, shishet, et.)
 - Sulmi ndaj lojtarëve, zyrtarëve, etj.

- **Fyerjet raciste**
 - Cfarë fyerje raciste, brohoritje-me zë kor, pankarta, flamuj, etj.
 - Numri i personave të involvuar,
 - Vendndodhja nga vien fyrjet raciste,
 - Veprimi i organizatorit në parandalimin e fyerjeve raciste
 - Aplikimi i 3 procedurave në rast të fyerjeve raciste:
 - **Ndalimi i ndeshjes, lajmërimi –vrejtja permes konferencierit (spikerit)në stadium (procedura 1)**
 - **Ndalimi i ndeshjes për 10 min, tërheqja e ekipeve në zheshtore (procedura 2)**
 - **Pezullimi i ndeshjes (procedura 3)**

- **Organizimi i sigurisë**
- A kanë qenë procedurat e hyrjes dhe sistemi i biletave i rregullt
- A kanë qenë masat e ndërmarra nga policia dhe sigurimi të mjaftueshme
- A ka qenë sistemi i akreditimit në rregull

- **Sjelljet e lojtarëve të ekipeve dhe zyrtarëve të tjerë,**
- **Organizimi i ndeshjes, a duhet të ndërmerren masa të tjera rreth organizimit**
- **Kushtet e fushës së lojës**
- **Kushtet e stadiumit**
- **Press organizimi**

Raporti i delegatit duhet të kompletohet jo më larg se ora 08:00 të ditës së nesërme, nga përfundimi i ndeshjes, përmes platformës online të FFK-së.

Raporti i delegatit duhet të plotësoj këto standarde:

- Shkëlqyeshëm (nuk ka nevojë të përshkruhet në raport)
- I pranueshëm (nuk është e domosdoshme përshkrimi vetëm të ceket përmirsimet në të ardhmën)
- I papranueshëm (te përshkruhet ku nuk janë përmbushur standardet)

Ju lutemi ju duheni të keni një fotoaparatur me vete, në mënyrë të keni sa më shumë foto-fakte të dokumentuara.

Emri	Roli	Emri	Roli	Emri	Roli	Emri	Roli

Delegati			
Emri	Roli	Emri	Roli

Të dhënat për ndeshjen - Golat

Nr	Emri Në Triko/Dres	Minuta	Lloji	Nr	Emri Në Triko/Dres	Minuta	Lloji

Zëvendësimet

Minuta	Nr	Lojtari Në Lojë	Nr	Lojtari Jashtë Loje	Minuta	Nr	Lojtari Në Lojë	Nr	Lojtari Jashtë Loje

Kartonët E Verdhë

Nr	Emri Në Triko/Dres	Minuta	Nr	Emri Në Triko/Dres	Minuta

Kartonë Të Kuq

Nr	Emri Në Triko/Dres	Minuta	Nr	Emri Në Triko/Dres	Minuta

Detajet e motit

- Shkëlqyeshëm (Nuk ka nevojë të përshkruhen detajet në raport)
- I pranueshëm (Nuk është e domosdoshme përshkrimi në raport)
- I papranueshëm (Të përshkruhet ku nuk janë përmbushur standardet)

Gjendja e fushës

- Shkëlqyeshëm (Nuk ka nevojë të përshkruhen detajet në raport)
- I pranueshëm (Nuk është e domosdoshme përshkrimi në raport)
- I papranueshëm (Të përshkruhet ku nuk janë përmbushur standardet)

Sjellja e ekipeve

- Shkëlqyeshëm (Nuk ka nevojë të përshkruhen detajet në raport)
- I pranueshëm (Nuk është e domosdoshme përshkrimi në raport)
- I papranueshëm (Të përshkruhet ku nuk janë përmbushur standardet)

Sjellja e tifozëve

- Shkëlqyeshëm (Nuk ka nevojë të përshkruhen detajet në raport)
- I pranueshëm (Nuk është e domosdoshme përshkrimi në raport)
- I papranueshëm (Të përshkruhet ku nuk janë përmbushur standardet)

Organizimi i përgjithshëm i ndeshjes

- Shkëlqyeshëm (Nuk ka nevojë të përshkruhen detajet në raport)
 - I pranueshëm (Nuk është e domosdoshme përshkrimi në raport)
-
- I papranueshëm (Të përshkruhet ku nuk janë përmbushur standardet)

Organizimi i përkujdesjes mjekësore

-
- Shkëlqyeshëm (Nuk ka nevojë të përshkruhen detajet në raport)
 - I pranueshëm (Nuk është e domosdoshme përshkrimi në raport)
-
- I papranueshëm (Të përshkruhet ku nuk janë përmbushur standardet)
-
-
-

Organizimi i mediave (fotograf, gazetar, etj)

- Shkëlqyeshëm (Nuk ka nevojë të përshkruhen detajet në raport)
 - I pranueshëm (Nuk është e domosdoshme përshkrimi në raport)
-
- I papranueshëm(Të përshkruhet ku nuk janë përmbushur standardet)
-
-
-

Incidente

- Shkëlqyeshëm (Nuk ka nevojë të përshkruhen detajet në raport)
 - I pranueshëm (Nuk është e domosdoshme përshkrimi në raport)
-
- I papranueshëm (Të përshkruhet ku nuk janë përmbushur standardet)
-
-
-

Shënime tjera

Fair Play Pikat	Klubi Vendas	Klubi Musafir
Kartonat e verdhë dhe kuq (1-10)		
Respekti për lojtarët kundërshtar (1-5)		
Respekti për zyrtarët e FFK (1-5)		
Respekti për zyrtarët e ekipeve (1-5)		
Sjellja e Fansave (1-5)		

10. Raporti plotësues-shtesë

- Nëse ka ndodhur ndonjë incident me të cilin duhet më tepër kohë, lidhur me përshkrimin e të njëjtit, delegati mundet të lajmëroj raportin shtesë të cilin duhet ta dërgojë jo më larg se 24 nga përfundimi i ndeshjes.
- Raporti shtesë duhet të plotësohet dhe të përshkruhet në detaje incidenti, personat nga të cilët merret informata, si oficeri i sigurisë, autoritetet publike, ekipet vendase, etj.
- Raporti plotësues nuk duhet të jep vlerësim personal të Delegatit, por duhet të përmbajë deklaratat dhe faktet e secilit person të intervistuar nga Delegati, dhe të njëjtat deklarata duhet të referohet se e kam pranuar nga personi x-emri dhe mbiemri, profesioni-funksioni aktual.

10.1. Raporti i referëve

- Raporti duhet të përmbaj listën e lojtarëve të dy ekipeve dhe zyrtarëve në ndeshje,
- Raporti duhet të përmbajë lojtarët dhe zyrtarët e shënuar me vërejtje-karton, apo ndonjë incident
- Duhet të sigurojnë dhe garantojnë se këto të dhëna janë të sakta, të futen në sistem

10.2. Fair Play raporti

- Raporti i fair play it duhet të plotësohet nga delegati për secilën ndeshje së bashku me referët
- Raporti i fair playt përpilohet me vlersimin numerik nga 01 deri 10, në bazë të sjelljeve dhe kartonëve të marrë gjatë lojës.

10.3. Raporti i Kompenzimit

- Delegati pas përfundimit të raportit të ndeshjes, fair play, në rast të raportit plotësues, duhet ta plotësoj raportin e rimbursimit-kompenzimit deri 48 orë pas përfundimit të ndeshjes.
- Raporti plotësohet dhe dërgohet ne FFK, për rimbursimin e mëditjeve për angazhimin e delegatit në ndeshjen e caktuar.
- Në rast të ndonjë lëshimi në raportim –të ndonjë fature të lejuar nga FFK-ja, apo rasti tjetër lidhur me rimbursimin-kompenzimin, duhet të raportohet jo më larg se 30 ditë nga përfundimi i ndeshjes-ngjarjes, si dhe të dokumentohet me fakte-faturo apo të ngjashme.

11. Stadiumet dhe Siguria

Standardet e stadiumeve janë të rregulluara në bazë të Ligjit mbi parandalimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarje sportive (R.Kosovës) , Rregullorës mbi infras. në stadiume, UEFA, etj.

11.1 Qëndrimi në këmbë, ulset pa mbështetëse, tribunat e përkohshme

- Qëndrimi në këmbë, ulset pa mbështet. janë të lejuara vetëm në stadiumet e kategorisë 1.
- Ulset pa mbështetëse në princip nuk duhet të lejohen, duhet që mbështetësja e shpinues të jetë minimum 30cm e lartë.
- Në asnjë stadium nuk lejohen tribunat e përkohshme për tifoz.

11.2 Ndriqimi

- Stadiumet e kategorisë 1, duhet të ketë së paku 350 Eh(lux)
- Stadiumet e kategorisë 2, duhet të ketë së paku 800 Eh(lux) dhe 350 Ev(lux)
- Stadiumet e kategorisë 3, duhet të ketë së paku 1200 Eh(lux) dhe 750 Ev(lux)
- Stadiumet e kategorisë 4, duhet të ketë së paku 1400 Eh(lux) dhe 1000 Ev(lux)

11.3 Biletat

- Të gjitha klubet vendase duhet të rezervojnë së paku 5% të kapacitetit të ulseve të stadiumit për ekipin mysafir.
- Ekipi vendas duhet të siguroj kushte për mikëpritjen e tifozëve mysafir, në pjesën e rezervuar për ta, të njoftojë dhe të jetë në kontakt të vazhdueshëm me organet publike, të jetë në kontakt me Delegatin e ndeshjes, të sigurohet në falsifikimin e biletave që këto bileta të rezervuara për tifozet e ekipit mysafir të mos bien në duar të tifozëve vendas, etj.

12.Stjuardët- Punëtorët e Sigurisë në ndeshje

- Ekipi vendas-organizatori duhet ti ndërmarri të gjitha masat lidhur me parandalimin e futjes në fushë, bllokimin e shkallëve të stadiumit, qëndrimin në këmbë, dyerve, dhe daljeve emergjente, Stjuardët duhen të angazhohen lidhur me kujdesin rreth këtyre masave të ndërmarra nga organizatori.
- Në gjithë stadiumin brenda fushës në perimetrimin e mbrendshëm dhe të jashtëm, duhet të angazhohen stjuardët, të cilët duhet të kenë dukje të kjartë të kenë uniformë të njejtë, si dhe të kujdesen për shikuesit dhe të gjithë të pranishmit në ngjarjen sportive.

13. Organizimi i ndeshjes

13.1 Klubet vendase ne stadiumet e tyre ku zhvillojnë ndeshjet munden të vendosin këto simbole-flamuj:

- Flamurin Kombëtar, Flamurin Shtetëror, Flamurin e FFK-së, UEFA, FIFA, Respect, si dhe në bisedë me klubin mysafir Flamurin e ekipit mysafir.
- Simbolet e tjera do të jenë në përgjegjisi të FFK-së të lejoj apo jo, ndonjë simbol tjetër përpos atyre që janë të lejuara më lartë.
- Cdo klub që nuk përfill këtë rregull do ti nënshtrohet procedurave disiplinore te rregullores së FFK-së.

13.2 Kamerat dhe TV në fushën e lojës

- TV instalimet rreth fushës duhen të mos rrezikojnë lojtarët apo tifozët, apo të mos interferoj në lojtarë dhe stafin teknik të ekipeve.
- Delegati duhet të kontrolloj kamerat dhe reklamat e vendosura ne fushë, duke ju përshtatur largësisë sipas rregullores së UEFA mbi sigurinë, të ketë në vëmendje sigurinë e lojtarëve, zyrtarëve të ekipeve, referëve dhe lojtarëve rezervë.
- Referi mundet te urdhëroj TV kamerat te largohen apo të sigurojnë perimetrin e lejuar sipas rregullores.

13.3 Fotografët e pozicionuar në fushë

- Në princip fotografët e kanë të lejuar ne fillim të ndeshjes pas rreshtimit te ekipeve dhe referëve në fushe, të bëjnë foto nga pozicioni i bankinave.
- Fotografët e fushës pas përfundimit të fotove të ekipeve, me fillimin e ndeshjes fotografët e fushes e marrin pozicionin mbrapa dy portave të ekipeve sipas përzgjedhjes së tyre. Nuk lejohet lëvizja apo qëndrimi në këmbë e tyre gjatë zhvillimit të ndeshjes.
- Ekipi organizator duhet të përkujdeset qe fotografet duhet te kene simbolet dalluese (akreditimin, jelekun e fotografit).

13.4 Ujitja e fushës

- Ujitja e fushës në princip duhet të përfundoj më së largu deri më 60 minuta para fillimit të ndeshjes.
- Me kërkesën e ekipit vendas mundet që fusha të ujitet nga 10 deri 5 min para fillimit të ndeshjes (nga 5 e deri max 8 minuta kohëzgjatja), si dhe gjatë pushimit të pjesës së parë.

13.5 Lartësia e barit

- Lartësia e barit në fushën në të cilën zhvillohet loja-ditën e lojës, nuk duhet të kalojë 30 mm.

13.6 Nxemja para lojës

- Ekipet duhet të kenë te ju mundësohet nxemja para fillimit te ndeshjes ne fushen ku do luhet ndeshja,

- Koha e fillimit duhet të jetë nga 30 minuta para fillimit të ndeshjes e më së largu deri 10 minuta para fillimit të ndeshjes (ta lirojnë fushën).
- Referët së bashku me organizatorin e ndeshjes mundën ta kufizojnë pjesët e fushës për nxemje ekipeve, me qëllimin e ruajtjes së kualitetit të fushës për lojë.

13.7 Femijet e topave

- Personat të cilët do ti mbajnë topat përrreth fushës, duhen të pozicionohen ashtuqë sa ma parë ta kthejnë topin në fushën e lojës.
- Për funksionimin e sistemit të një apo shumë topave duhet të mirret vendimi mes dy ekipeve dhe delegatit në mbledhjen organizative para ndeshjes.
- Fëmijët e topave nuk duhet të kalojnë lartësinë prej 1 m e 40 cm është rekomandim i UEFA.
- Duhet të kenë uniformë të dallueshme, si dhe mos të luajnë me top deri sa ndeshja zhvillohet.

13.8 Procedura e përshëndetjes

- Secili ekip dhe lojtarët duhen të kalojnë procedurën e përshëndetjes mes vete.
- Ekipi mysafir fillon ti përshëndes referët si dhe lojtarët e ekipit vendas.
- Në princip ekipi vendas pozicionohet në të djathtë ndërsa ekipi mysafir në të majtë.

13.9 Propozimet për aktivitete nga ekipi vendas

- Cdo aktivitet të ndërmarr në një ndeshje duhet lajmëruar delegati më së largu në mbledhjen organizative, pra i nënshtrohet aprovimit paraprak,
- Duhet të spjegohet qëllimi i aktivitetit, të prezantohet si duket.
- Duhet shpjeguar ekipeve se në rast të shpalosjes së ndonjë baneri apo pankarte, e cila nuk është nënshtuar procedurave të aprovimit, do të pasoj ndëshkimi i ekipit –të cilit i takojnë tifozët.
- Delegati i ndeshjes do të jetë personi i fundit i cili mundet të merr vendimin për aprovimin apo mos aprovimin e një aktiviteti të propozuar.

13.10 Minuta e Heshtjes

- FFK mundet të vendos lidhur me lejimin e një minute heshtje para fillimit të ndeshjes.
- Përfaqësuesit e ekipeve mundën ti adresohen me kërkesë delegatit për një minut heshtje, por FFK duhet të merr vendim final lidhur me një minut heshtje.
- Delegati duhet ti informoj ekipet dhe referët lidhur me vendimin final për një minut heshtje.
- Minuta e heshtjes para fillimit të lojës bëhet në atë mënyrë që lojtarët dhe referët e dy ekipeve shkojnë në qendrën e fushës-vija e rrethit përballë njëra tjetrës, referët në mes tyre, ndërsa ekipet e rezervistëve dhe zyrtarët para bankinave të tyre.

13.11 Arritja e ekipeve dhe zyrtarëve

- Ekipet dhe zyrtarët duhet të jenë në stadium më së largu 75 minuta para fillimit të ndeshjes (cdo vones është objekt i sanksioneve disiplinore).
- Si delegat i ndeshjes ju duhet të arrini më së largu deri 90 minuta para fillimit të ndeshjes.
- Detajet tjera duhet të përcaktohen në mbledhjen organizative në mes delegatit dhe ekipeve.

13.12 Lista e ekipeve dhe Lista e lojtarëve

- Për të gjitha garat e futbollit lista e ekipeve duhet të jetë gati dhe dorëzohet-sistemi online te delegati, referët, doping kontrolla, media jo më larg se 75 minuta para fillimit të ndeshjes (cdo vonesë është objekt i sanksioneve disiplinore),
- Në rast të mos funksionimit të internetit apo sistemit online, listën e ekipeve lojtarëve duhet printuar apo shkruar me dorë dhe dorëzuar te delegati, referët, doping kontrolla, media.
- Lista e lojtarëve përmban emrin mbiemrin, numrin identifikues –ID, numrin e fanelës, dhe a do të luaj apo do të jetë në bankën rezervë (P- do të thotë që luan dhe X- nuk luan).

13.13 Ndërrimi i lojtarit të dëmtuar gjatë nxemjes

- Ndërrimi i lojtarit gjatë nxemjes është i mundur vetëm në rast aksidental apo ndonjë rasti tjetër të papritur që mund ti ndodhi lojtarit.
- Procedura duhet të shkruhet asisoji që doktorri i ekipit duhet të përpilojë raport me shkrim për të arsyetuar lëndimin e papritur të lojtarit apo sëmundjen e papritur, me diagnozën konkrete si dhe sugjerimin e kurimit të së njëjtës. Raporti duhet dorëzuar te Delegati, referët, doping kontrolla, si dhe të dërgohet komisionit të Garave FFK, Komisionit Mjekësor të FFK (në rast të shkeljeve etike të doktorit do të mirren masa disiplinore ndaj ti, lojtarit dhe klubit).
- Referi do ta lejoj ndërrimin duke shkruar me dorë në listën e lojtarëve zëvendësuesin dhe bashkëngjitur raportin mjekësor.

13.14 Banka Rezervë, karrigat shtesë dhe vendi i nxemjes

- Zakonisht vendi i nxemjes së lojtarëve duhet të jetë pas asistentit të parë, dhe maksimum 3 lojtarë mund të jenë në nxemje.
- Trajneri i nxemjes mundet të bashkëngjitet lojtarëve në nxemje.
- Në princip 5 karriga shtesë për ekip janë të lejuara për stafin teknik.
- Ekipet mundet të dakordohen në mbledhjen organizative për karriga shtesë për stafin teknik të ekipeve,
- Lojtarët të cilët nuk janë të shënuar në listën e lojtarëve rezervë nuk mundet të ulen në bankinë apo karriga shtesë.
- Numrin e lojtareve dhe stafit teknik për secilën garë vendoset në bazë të rregullores së garave për garën specifike.

13.15 Lojtari i suspenduar

- Lojtari i suspenduar duhet menjëherë ta lëshojë fushën, bankën rezervë deri në përfundimin e ndeshjes 5 minuta pas përfundimit të ndeshjes mundet të bashkohet me ekipin.
- Lojtari i suspenduar nuk mundet të jetë prezent gjatë zhvillimit të ndeshjes në fushë,
- Mundet të jetë në fushë para dhe pas përfundimit të ndeshjes (5 minuta para dhe pas)
- Mundet të japi intervista para dhe pas përfundimit të ndeshjes flash ose brenda stadiumit(5 minuta para dhe pas përfundimit)
- Mundet të japi intervista para dhe pas përfundimit të ndeshjes flash në fushë (5 minuta para dhe pas përfundimit)

13.16 Trajneri i Larguar

- Trajneri i larguar duhet ta lëshoj menjëherë fushën, të vendoset në tribuna të stadiumit, nuk guxon të komunikoj me ekipin apo zyrtarët.
- Trajneri i larguar mundet të shkoj në zveshtore, ne pushimin e pjesës së parë, nuk mundet të ulet në asnjë vend ku mundet të komunikoj me ekipin stafin në bankinë,
- Trajneri i larguar mundet të komunikojë me media pas përfundimit të ndeshjes, por mundet edhe ta dërgoi asistentin e tij.


13.17 Pushimi për lojtarë në kushte atmosferike (temperature)

- Nëse temperatura para fillimit të ndeshjes tregon 32 gradë, atëherë me kërkesën e ekipeve Delegati mundet të aplikojë pushimin për lojtarë.
- Pushimi gjatë lojës do të implementohet në minutën e 25 të pjesës së parë dhe 75 të pjesës së dytë. Ekipi që ka topin e godet jashtë vijës në drejtim të asistentit të referit, lojtarët shkojnë të freskohen te bankina e ekipeve me uje me pushim 1 minut, loja do të kompensohet pas kalimit te 45 minutave te rregullt.
- Në rast që temperatura para fillimit të ndeshjes shënon -15 gradë, atëherë ndeshja mund të zhvillohet vetëm me aprovimin e dy ekipeve.

14. Media TV

- Delegati para fillimit të ndeshjes duhet të ketë kujdes t'i verifikoj distancën e TV kamera dhe reklamave përgjatë fushës së lojës.
- Shembull sa dhe kush duhet të jetë në perimetrin e fushës së stadiumit:

E.2 Media and TV camera positions



1. Teams pre-match
 2. Photographers pre-match
 3. Photographers during the match
 4. Pitchside halfway camera
 5. 20m cameras
 6. Hand-held TV camera (pre-match, line-up and post-match)
 7. Steadicams during the match
 8. Reverse-angle cameras
 9. Additional TV cameras (reserved area of minimum 10x2m)
 10. Host broadcaster cameras (only remote cameras in front of boards)
 11. Substitutes' bench
- Advertising boards

Note: Diagram shows standard pitch set-up. All details subject to individual stadium conditions. All pitchside equipment to be positioned so that it does not present any danger to the players, coaches and match officials.

15. Anti-Doping

- Personi i Doping kontrollës është sekret dhe është i paparalajmëruar, mund të vjen në cdo ndeshje, jo më heret se 60 min para fillimit të ndeshjes dhe më së largu deri në përfundimin e ndeshjes.
- Doping kontrolla duhet të ketë dhomën e veçantë, të sigurtë, Toalet, Ëi-Fi internet, të ketë së paku 2 shtretër, një tavolinë, frigorifer dhe min. 30l ujë në frigorifer.
- Doping kontrolla duhet gjithsesi të ketë listën e lojtarëve që janë në lojë dhe rezervistët të cilët janë potencialisht të mundshëm për testim.
- Ekipi vendas është i obliguar që çdo lojë pranë delegatit, t'i rezervoj një karrikë në tribunat e stadiumit.
- Përzgjedhja e lojtarëve për testim bëhet në atë princip që dy lojtarë nga përbërja e parë dhe dy lojtarë nga rezervistët, nga dy ekipet në prezencën e dy mjekeve të ekipeve, 15 min para përfundimit të ndeshjes, me anë te shortit.
- Lojtarët e përzgjedhur duhet të japin mostër të urinës, gjakut ose urinës dhe gjakut.